



Raport i Monitorimit të Aktiviteteve Institucionale në Luftën Kundër Korrupsionit

Aktiviteti kryesor në fushën kundër korrupsion gjatë muajit shkurt ishte krijimi i Task-Forcës për Luftën kundër korrupsionit si dhe Miratimi dhe dekretimi nga Presidenti i Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publikë

Raporti i parë | Shkurt 2010

Rruga "UCK" 46/5, 10000 Prishtinë,
Mob: +377(0) 44 131 542
www.levizjafol.org | info@levizjafol.org

Mbështetur nga:



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA



INSTITUTE FOR
**Sustainable
Communities**

Rreth lëvizjes FOL

FOL angazhohet për të fuqizuar ndikimin qytetar në vendimmarrje për qeverisje të përgjegjshme dhe efikase. FOL, punon për të përmirësuar dhe arritur nivel më të mirë të përfaqësimit të qytetarëve dhe interesave të tyre në institucionet vendimmarrëse. FOL punon për qeverisje të mirë dhe të bazuar në parime demokratike, për institucione të përgjegjshme, transparente dhe llogaridhënëse si dhe për zbatim dhe hartim të ligjit me pjesëmarrje.

Shpenzimi i fondeve publike, konfliktit i interesit, neglizhenca dhe përgjegjësia institucionale si dhe qasje në informacione zyrtare, përbëjnë çështjet kryesore të punës së FOL. Në përmbushje të këtyre qëllimeve, FOL mëton të luftojë apatinë dhe indiferencën qytetare ndaj vendimmarrjes si dhe të bëjë më aktiv dhe më të dëgjueshëm zërin e qytetarit; ta bëjë atë pjesë aktive të interesit të komunitetit dhe përherë të gatshëm që t'i kundërvihet abuzimit, keqpërdorimit, korrupsionit dhe formave tjera deformuese të qeverisjes.

FOL nëpërmjet hulumtimit, mobilizimit dhe rrjetëzimit, do të realizojë aktivitete që do të rrisin presion publik në proceset vendimmarrëse, politike, ekonomike e sociale për të shtyrë përpara alternativa dhe mundësi më të mira të zgjidhjes së problemeve të qytetarëve.

FOL nënkupton një thirrje për kritikë dhe opozitë konstruktive kundrejt politikave jofunksionale, abuzimit me pushtetin dhe fuqinë politike. FOL, kërkon nga qytetarët, tanimë të një shteti të pavarur që të reagojnë për të mbrojtur vetë shtetin për të cilin u sakrifikuan dhe punuan.

FOL ofron dhe mbështet individët dhe organizatat që punojnë për të përparuar përpjekjet në zhvillimin dhe ndërtimin e shoqërisë së hapur dhe demokratike. Ne do të realizojmë dhe mbështesim veprime jo të dhunshme dhe konstruktive për të kundërshtuar veprime që kërcënojnë dhe degradojnë të drejtat e individit, grupeve, etnive dhe komuniteteve pa dallim feje dhe përkatësie nacionale.

Falënderime

Publikimi i këtij raporti u mundësua nga USAID-i përmes Programit për Fuqizimin e Shoqërisë Civile në Kosovë në partneritet me Institute for Sustainable Communities

Opinionet e shprehura në këtë dokument janë ato të shkruaj autorin dhe jo medoemos reflektojnë pikëpamjet e Agjencionit Amerikan për Zhvillim.

Rreth projektit:

Korrupsioni dhe përhapja e tij e gjerë në institucionet vendimmarrëse dhe në shoqëri në përgjithësi paraqet një pengesë serioze në zhvillimin dhe integrimin e vendit në Bashkimin Evropian. Ky fenomen po dëmton shërbimet esenciale për qytetarët dhe po rrit në vazhdimësi shkallën e mos besimit të tyre ndaj institucioneve vendore.

Raporti i Progresit 2009 nga Komisioni Evropian vlerëson korrupsionin si një çështje serioze ku autoritetet kosovare kritikohen për mos angazhimin e mjaftueshëm kundër luftimit të kësaj dukurie. Sipas këtij dokumenti institucionet kosovare mungojnë strategji për luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionin ndërsa sistemi gjyqësor po ashtu ka mangësi të mëdha. Për më tepër, nuk ekziston një strukturë funksionale që do të kishte përfshirë institucionet kryesore të punonin të koordinuar dhe në harmoni. Mungesa e komunikimit e bën edhe më të vështirë koordinimin e këtyre institucioneve.

Projekti “Monitorimi i aktiviteteve kundër korrupsion” mbështetet nga Institute for Sustainable Communities (ISC) dhe USAID. Qëllimi kryesor i këtij raporti është monitorimi i përgjigjeve të institucioneve të ndryshme në luftën kundër korrupsion. Përkatësisht, në kuadër të këtij raporti përfshihet monitorimi mujor i aktiviteteve kundër korrupsion të Kuvendit të Kosovës, Qeverisë së Kosovës, Institucioneve për sundim të ligjit dhe Agjencisë Kundër Korrupsion. Ky projekt gjithashtu synon mbështetjen më të madhe publike ndaj këtyre aktiviteteve dhe forcimin e marrëdhënieve mes institucioneve në luftimin e kësaj dukurie. Përmbledhja e përgjigjeve do të përfshihet në raportin mujor të publikuar nga Lëvizja FOL. Projekti përfshin po ashtu organizimin e konferencave për media, tryezave të rrumbullakëta dhe krijimin e ueb faqes me zhvillime të fundit. Projekti ka filluar nga janari i vitit 2010 dhe të zgjasë deri në fund të muajit dhjetor, 2010

Përmbledhje ekzekutive

Gjatë monitorimit të muajit shkurt është vërejtur përkushtim i vogël i deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës për të diskutuar rreth çështjeve të korrupsionit. Në komisione të ndryshme parlamentare nuk janë përmendur raste specifike të korrupsionit.

Kuvendi i Kosovës gjatë muajit shkurt ka miratuar Ligjin për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publikë. Ligji është shpallur me Dekretin e Presidentit të Republikës së Kosovës në fillim të muajit mars.

Qeveria e Kosovës në anën tjetër, ndonëse e ka prioritet sundimin e ligjit dhe luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, nuk është vërejtur dhe aq me aktivitetet e saja në këtë drejtim. Fare në fund të muajit Qeveria e Kosovës ka marrë vendim për

krijimin e një task force që do të ndihmonte luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Agjencioni Anti-Korrupsion si institucion i pavarur për pranimin e informatave të ndryshme rreth korrupsionit në nivele lokale e qendrore gjatë shkurtit nuk kanë bërë me dije rastet që janë duke i hetuar. Ata janë zotuar për publikim të raportit vjetor 2009, por jo edhe për rastet e pranuar gjatë dy muajve të parë të këtij viti.

Gjyqësori në anën tjetër është treguar më pak i vëmendshëm karshi prioritetit qeveritar. Mund edhe të jetë punuar diçka në luftën kundër korrupsionit, mund edhe të jetë dënuar dikush, por rastet FOL i ka hasur vetëm në media dhe jo nga statistikat e gjykatave apo prokurorive.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) menaxhon me gjykatat dhe si i tillë është i obliguar të ketë statistikat e rasteve të proceduara apo zgjidhura në gjykatë. Në muajin shkurt KGJK ka publikuar vetëm raportin 2009 statistikor mbi punën e gjykatave të rregullta. Ky institucion nuk posedonte asnjë statistikë për dy muaj e parë të vitit 2010. Edhe Ministria e Drejtësisë si institucion që merret me prokuroritë dhe administrimin e tyre nuk ka të dhëna mujore për punën e prokurorive në tërë Kosovën.

Mediet në kuadër të punës së tyre dhe temave të ndryshme të hulumtuara, kanë publikuar disa raste të dyshimit për keqpërdorime madje edhe të milionave. Ndonëse puna e medieve është parë, nuk është vërejtur punë institucionale për elaborimin e mëtejshëm të këtyre rasteve, qoftë nisjen e hetimeve apo diç të ngjashme.

Dogana e Kosovës është i vetmi institucion nga i cili FOL ka arritur të sigurojë të dhëna mujore lidhur me rastet kundër-korrupsion.

Rekomandime

Përveç krijimit të institucioneve të reja për luftimin e korrupsionit, institucionet vendore dhe ato ndërkombëtare duhen të fokusohen në ndërtimin e një infrastrukture të fortë ligjore. Kosova nuk ka ende ligje që sanksionojnë korrupsionin apo e bëjnë lehtë të përballueshëm dënimin.

Gjykata duhen të japin një përgjigje për mos gjykimin e rasteve të korrupsionit dhe duhet të krijohen mekanizma të gjykatës, të cilët duhet të raportojnë për hetimet e tyre në baza mujore.

Prokuroria duhet të sigurojë që për lëndët e pranuar për keqpërdorime të fillohen hetimet brenda afatit të paraparë ligjor.

Këshilli Gjyqësor dhe Prokurorial i Kosovës, si dhe Ministria e Drejtësisë të sigurojnë statistika rreth rasteve që i procedojnë në gjykata përkatësisht prokurori dhe të klasifikohen ato jo si tërësi por të ndara varësisht nga veprat penale dhe në kategori.

Puna e Kuvendit Kundër Korrupsionit

Të rejat e fundit për sa i përket infrastrukturës ligjore anti-korrupsion janë: Miratimi dhe hyrja në fuqi e Ligjit për Agjencinë Kundër Korrupsion; Miratimi dhe hyrja në fuqi e ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin Funkcionit Publik; fillimi i procesit të amandamentimit të Kodit Penal të Kosovës, fillimi i zbatimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit kundër Korrupsionit.

Gjatë muajit Shkurt, deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë miratuar vetëm Ligjin për Deklarimin, Kontrollin dhe Prejardhjen e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik. Ligji është shpallur me Dekretin e Presidentit të Republikës së Kosovës në fillim të muajit mars.

Aktiviteti kryesor në fushën kundër korrupsion gjatë muajit shkurt ishte krijimi i Task-Forcës për Luftën kundër korrupsionit si dhe Miratimi dhe dekretimi nga Presidenti i ligjit për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhuratave të zyrtarëve të lartë publikë

Një ligj i tillë nuk është fuqizuar me gjithë presionet e ardhura nga shefi i Agjencionit kundër korrupsion, Hasan Preteni se një ligj i tillë duhet hyrë në fuqi para marsit për shkak se data 31 mars është caktuar si afati i fundit kur zyrtarët e lartë të institucioneve të Kosovës janë të obliguar ta deklarojnë pasurinë që e kanë në emër të tyre.

Ligji për deklarimin dhe prejardhjen e pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë, rregullon kontrollin publik të pasurisë, të hyrat dhe përfitimet e tjera materiale, detyrimet financiare nga zyrtarët publikë, familjarët e tyre dhe personat e lidhur me ta, duke përfshirë sanksionet e përcaktuara me këtë ligj. ¹

Ndërsa, miratimi i ligjit për financimin e partive politike, konsiderohet si një nevojë tjetër imediate që do ta parandalonte financimin e subjekteve politike nga burimet e dyshimta kriminale.

Kështu, përfundimisht, pas zvarritjes dhe qarkullimit nga zyra në zyre gjatë muajit shkurt edhe ky ligj që hyn në kuadër të pakos së ligjeve për luftën ndaj korrupsionit ka hasur vëmendje.

Kuvendi i Kosovës përkatësisht Komisioni për Buxhet dhe Financa i këtij kuvendi ka mbajtur një dëgjim publik i cili kishte për qëllim përcaktimin e fushës së financimit të partive politike. Dëgjimi publik është udhëhequr nga kryetari i këtij komisioni Gani Koci ndërsa është thënë se ka për qëllim që të bëhet një ligj sa më i mirë. Por ende nuk dihet se kur do të finalizohet ky ligj. ² Përkundër ftesës, është ndjerë ndjeshëm mungesa e përfaqësuesve të partive kryesore politike.

¹<http://evropaelire.org/content/article/1964179.htm>

² Nga dëgjimi publik i monitoruar nga aktivistët e FOL

Por edhe komisionet tjera gjatë mbledhjeve të tyre kanë diskutuar në lidhje me çështje të ndryshme. Disa përfaqësues të këtyre komisioneve pas mbajtjes së mbledhjes kanë akuzuar disa nga përfaqësuesit politik që ndonëse kishin qenë të ftuar nuk kishin marrë pjesë në mbledhje të komisioneve.

P.sh. Ministri i Postës dhe Telekomunikacionit, Fatmir Limaj nuk iu ka përgjigjur ftesës së Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion të Kuvendit. Limaj ishte ftuar nga ky komision për të njoftuar anëtarët rreth gjendjes aktuale në lidhje me projektin e auto rrugës, Morin-Merdare.³

Në anën tjetër edhe shoqëria civile, ndër ta edhe lëvizja Fol në njërin prej deklaratave javore në kuadër të projektit Matësi i së Vërtetës ka konsideruar të gjithë negociatat dhe komplet procesin projektit të auto rrugës, Morinë-Merdare si jo transparent.

Edhe Ministri i Punëve të Brendshme përkatësisht zyrtarët e MPB-së nuk janë përgjigjur ftesës së Komisionit për Siguri dhe Punë të Brendshme, Zyrtarët e MPB-së kishin qenë të ftuar me qëllim të dhënies së sqarimeve rreth mjeteve të ndara për policët e Kosovës pas mbajtjes së grevës së Njësisë të Specializuara të Policisë së Kosovës.

Anëtarët opozitar të këtij komisioni pas mbledhjes kanë deklaruar se MPB-ja përkatësisht Qeveria e Kosovës me ndarjen e këtyre mjeteve ka shkelur Ligjin për Buxhetin, ligj që sipas tyre ekzekutivi i vendit e ka miratuar vet.⁴

³ <http://assembly-kosova.org/?cid=1,128,2860>

⁴ Nga monitorimi i mbledhjeve të Komisionit nga FOL

Puna e Qeverisë Kundër Korrupsionit

Gjatë muajit shkurt, Qeveria në bashkëpunim me EULEX-in kanë themeluar “Task Force” kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Në mbledhjen e rregullt të 110-tën me radhë, Qeveria e Republikës së Kosovës ka aprovuar vendimin për mbështetjen e forcimit të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës. Një forcim i tillë i prokurorëve special është përmendur edhe në mbledhjen e pesëmbëdhjetë të Bordit bashkërendues për sundimin e ligjit në të cilën mbledhje kanë marrë pjesë krerë të qeverisë e të EULEX-it.

Përkatësisht, Agjensionit Kundër Korrupsion, Komisionit ndërministror për luftimin e korrupsionit, Prokurorisë Speciale kundër korrupsionit, Zyrës së Auditorit Gjeneral, dhe Qendra për inteligjencë ndërkombëtare do ti shtohet edhe një institucion për luftimin e korrupsionit.

Vendimi për themelimin e kësaj Task Force është marrë në fund të muajit shkurt ndonëse për një gjë të tillë, zyrtarisht apo jo zyrtarisht është folur gjatë gjithë muajit.

Task Forca sipas vendimit të qeverisë do të funksionoj në kuadër të Prokurorisë Speciale të Kosovës. Kjo prokurori udhëhiqet nga një ndërkombëtarë derisa zëvendësja e saj është vendore dhe e zgjedhur në fazën e parë të procesit të riemërimit. Task Forca parasheh që të ketë tetë prokuror në mesin e tyre pesë prokuror vendor të prokurorisë speciale dhe tre ndërkombëtar.

Krijimi i kësaj Task Force përveç që ka marrë mbështetjen e vendësve, është përshëndetur edhe nga institucione ndërkombëtare. Institucionet ndërkombëtare duke përfshirë, EULEX-in, Zyrën Civile Ndërkombëtare, etj. janë shprehur të gatshme që të përkrahin luftën e qeverisë së Kosovës.

Mirëpo, mbetet të shihet se sa do të jenë këta prokuror funksional dhe sa politika nuk do të ndikoj në ta kur kihet parasysh fakti se kjo Task Force është themeluar nga Kryeministri i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi.

Në fakt, përshtypja e përgjithshme është se vendimi i qeverisë për formimin e një Task Force në Prokurorinë speciale kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar mund të jetë edhe shkelje dhe ndërhyrje në punët e organit të akuzës. Praktika e deritashme ka dëshmuar që Task Forcat janë krijuar më shumë për qëllime të marrëdhënieve me publikun. Rasti i fundit i vjedhjes së provave dhe drogës në Polici dhe krijimi i Task Forcës së udhëhequr nga vetë Sheremet Ahmeti nuk ka dhënë asnjë rezultat. Përveç kësaj, vendorët nuk kanë kompetenca në Prokurorinë Speciale pasi kjo prokurori udhëhiqet nga EULEX-i dhe punohet sipas direktivave të këtij misioni.

Shoqëria Civile, në anën tjetër konsideron se krijimi i institucioneve të reja në njërin anë do të thotë ngarkesë shtesë për buxhetin e Kosovës dhe shtimin e konfuzionit se kush

është përgjegjës për luftimin e korrupsionit. Gjithashtu, ata pohojnë që krijimi i institucioneve të reja tregon vetëm një mënyrë për ta fshehur mungesën e veprimit dhe të vullnetit për të bërë ndryshime fizike në luftë.

Agjensioni Kosovar Kundër Korrupsionit

Në muajin shkurt edhe Agjensioni Kosovar Kundër Korrupsionit ka nënshkruar memorandum bashkëpunimi me doganën. Në ueb sajtin e këtij agjencioni, shkruan që qëllimi i këtij bashkëpunimi është që palët t'i ofrojnë njëra tjetrës informata për çështjet që janë me interes të dyanshme në fushën e parandalimit, hetimit dhe ndalimit të dukurive korruptive dhe veprave penale; do të shkëmbejnë informacione; dhe të bashkëpunojnë plotësisht në zbatimin e Ligjit Kundër Korrupsionit.

Gjithashtu sa i përket statistikave për rastet që janë dhe proceduar më tutje, ky institucion nuk ka bërë me dije rastet që janë duke u hetuar e as numrin e informatave të pranuar gjatë muajve të parë të vitit 2010. Ata janë zotuar për publikim të raportit vjetor 2009, por jo edhe për rastet e pranuar gjatë dy muajve të parë të këtij viti.

Ndërsa në intervistën e dhënë për emisionin Jeta në Kosovë, drejtori i këtij agjencioni ka pohuar që nga themelimi i këtij agjencioni, prej të gjitha rasteve të cilat ky institucion ka denoncuar nuk është mbajtur asnjë gjykim dhe askush nuk ka hyrë në burg. Sipas tij, nuk ka presion prej qeverisë por nuk ka as përkrahje⁵.

EULEX

Misioni EULEX ka vazhduar me punën e tij. Ndonëse nuk kanë ofruar statistika të plota, zyrtarë brenda këtij institucioni kanë konfirmuar për lëvizjen Fol se janë duke zhvilluar hetime ndaj rasteve të korrupsionit. Sipas burimeve zyrtare të këtij institucioni, 33 raste të krimit të organizuar presin që të procedohen në gjykatë. Tri raste kanë mbërritur në fazën kryesore të gjykimit dhe tri vendime rreth krimit të organizuar janë marrë. Gjyqtarët e EULEX-it gjithashtu kanë proceduar katër vendime që kanë të bëjnë me anti-korrupsion.

Ndonëse zyrtarisht Fol nuk është njoftuar rreth epilogëve të gjykimeve të mbajtura nga EULEX-i për rastet e korrupsionit, FOL ka mësuar nga mediat se gjatë muajit shkurt është dhënë dënimi për keqpërdoruesit e mjeteve të “Fondit Haradinaj”.

⁵ Intervista Ekskluzive me Kristofer Dell dhe Hasan Preteni, *Jeta në Kosovë*, 18/02/10

Jahja Lluka, ka marrë dënimin prej dhjetë muajsh me kusht dhe dënimin shtesë prej 10 mijë eurosh derisa dy të akuzuarit tjerë Hashim Sejdiu e Milazim Abazi janë liruar të pafajshëm.

Ndërkohë, shefi i prokurorëve të EULEX-it Theo Jackobs, në një intervistë për media ka thënë gjatë shkurtit se janë duke zhvilluar me qindra hetime të ndryshme. Ai ka mohuar gjatë kësaj kohe të ketë thënë ndonjëherë se pritet arrestimi i “peshqve të mëdhenj”. Ai ka njoftuar se prokurorët dhe hetuesit e EULEX-it në bashkëpunim me vendorët janë duke bërë hetime të mira rezultati i të cilave pritet të shihet në pranverën e këtij viti.

Gjyqësori

Të thirrura për të hetuar krimin e persona të ndryshëm që kanë rënë ndesh me ligjin si dhe për të dhënë epilogë për raste të ndryshme, duke përfshirë edhe korrupsionin, gjykatat dhe prokuroritë, janë treguar pak efikase në këtë luftë që Qeveria e vendit e ka prioritet.

Mediat në Kosovë madje kanë raportuar për një bllokadë totale nëpër gjykata e prokurori për faktin se Procesi i Riemërimit ka humbur vullnetin e tyre për punë.

Lëvizja FOL gjatë monitorimit të punës së këtyre gjykatave nuk ka vërejtur ndonjë rast specifik të gjykuar apo hetuar.

Mund edhe të jetë punuar në këtë drejtim por së paku aktivistët e lëvizjes nuk kanë arritur të kenë qasje në statistikat mujore të këtyre institucioneve për fuqizimin e sundimit të ligjit.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, si institucion për menaxhimin e punës së gjyqësorit në Kosovë, nuk kanë të dhëna mujore rreth punës që bëhet në këto gjykata. Kërkesa zyrtare nga Fol është refuzuar me argumentimin që mbledhja e të dhënave është në proces e sipër. Këshilli Gjyqësor i Kosovës gjatë muajit shkurt ka publikuar statistikat e vitit 2009 por jo edhe statistikat për dy muajt e parë të 2010-tës.

Edhe Ministria e Drejtësisë si institucion që merret me prokuroritë dhe administrimin e tyre nuk ka të dhëna mujore për punën e prokurorive në tërë Kosovën. Edhe zyrtarë nga ky institucion kanë raportuar vetëm për statistikat vjetore të 2009-tës por jo edhe për muajt e parë të 2010-tës.

Siç shihet edhe muaji shkurt ka kaluar pa as edhe një rast të rëndësishëm të proceduar për korrupsion. Në një ndër të përditshmet Kosovare, ku citohet edhe drejtori i Agjencionit Kundër Korrupsion, z. Hasan Preteni, ka shkruar që mijëra informata të po këtij Agjencioni kanë mbetur në sirtarët e prokurorive dhe të gjykatave të vendit. Ndërsa ato për të cilat është ngritur akti akuzues, presin gjykim.

Ndërsa me gjithë kërkesën që lëvizja Fol i ka bërë për disa ditë radhazi nga Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Prokuroritë ishte e pamundur që të merret edhe një prononcim, ku edhe shume ka pas që kanë injoruar kërkesën.

Dogana e Kosovës

Dogana e Kosovës, është njëra ndër institucionet të cilat posedonin përmbledhje mujore të rasteve për korrupsion. Ky organ në kuadër të planeve të angazhimit kundër korrupsion për vitin 2010 ndër të tjerat ka përfshirë hetimin e rasteve, zhvillimin e procedurave disiplinore (procedurat lokale dhe Borde Disiplinore) dhe monitorimin e rasteve disiplinore (ne Prokurori, Gjykata dhe organe tjera relevante). Sipas raportit të siguruar nga ky organ nga periudha janar deri në mesin e muajit shkurt janë shqyrtuar këto masa:

Gjithsej një masë disiplinore qe është përjashtim nga puna. Nga janari gjithsej janë iniciuar në Sektorin e Standardeve Profesionale 6 raste. Prej tyre 3 raste janë iniciuar nga palët, prej tyre, 1 rast akuzë për korrupsion 2 raste për sjellje joprofesionale. 3 raste të tjera janë iniciuar nga vet dogana, prej tyre 1 rast - dyshim për keqpërdorim të detyrë; 1 rast - dëmtim i pronës së doganës dhe 1 rast - sjellje joprofesionale.

Mediat

Gjatë muajit shkurt mediat e shkruara në Kosovë kanë qenë të përqendruara në çështje të ndryshme, duke mos anashkaluar edhe rastet e dyshimit për korrupsion dhe zbulimin e aferave dhe dosjeve të ndryshme rreth kësaj çështjeje.

E përditshmja “Koha Ditore”, disa herë gjatë muajit që lamë pas ka raportuar rreth një rasti të korrupsionit në Ministrinë e Punëve të Brendshme të Kosovës. Bëhet fjalë për tenderin milionësh të targave të kësaj ministrie.

Gazeta ka raportuar se në ditën e hapjes së tenderit në fjalë, kompania që sipas gazetës është zgjedhur fituese “Karposh Kos&UTSCH”, kishte konkurruar me çmim prej 14,3 eurove për një palë tabela. Por gazeta ka raportuar më pas se në ditën e zgjedhjes së fituesit nga ana e MPB-së, çmimi ishte rritur dhe kishte shkuar deri në 20,5 për një palë tabela që sipas gazetës i bie 6, 20 më shumë.⁶

Tenderi i cili sipas gazetës ka paraparë prodhimin e 250.000 tabela brenda një viti me shpalljen e fituesit më të shtrenjtë dhe anashkalimin e ofertave më të lira i ka shkaktuar dëm kësaj ministrie rreth 1.4 milion euro.

⁶ koha.net

Rreth këtij tenderi gjatë shkurtit ka reagu edhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës duke vlerësuar se “abuzimi ekstrem” dhe kjo qeverise me një korrupsion të lartë sipas AAK-së po ndikon drejtë për drejtë në largimin e investitorëve nga Kosova.

Por, Ministria e Punëve të Brendshme i ka hedhur poshtë tërë këto akuza duke thënë se ende nuk është shpallur tenderi fitues.

Në anën tjetër, gazeta “Koha Ditore”, nga burime të saja konfidenciale brenda misionit ndërkombëtar për sundim të ligjit EULEX, kanë njoftuar se ky mision ka hapur hetimet rreth keqpërdorimeve që dyshohet se janë bërë.⁷

Veç kësaj media gjatë këtij muaji kanë raportuar edhe për katër të arrestuar në lidhje me dyshimin për keqpërdorimin e fondeve gjatë asfaltimit të një rruge në Mitrovicë. Parregullsitë në shtrimin e rrugës që ka kushtuar 180.000 euro sipas gazetës “Zëri”, ka vënë në pranga katër persona. Njëri nga të arrestuarit, sipas gazetës është punonjës në Ministrinë e Transportit, një tjetër biznesmen ndërsa dy të tjerë punonjës përkatësisht ish-punonjës në Kuvendin Komunal në Mitrovicë.⁸

Ata janë arrestuar nga policia e Kosovës pas një hetimi të zhvilluar nga Njësia për krime ekonomike derisa rasti sipas shefit të Agjencionit Anti-Korrupsion, është Hasan Preteni është iniciuar nga hetuesit e agjencisë që ai drejton.

E njëjta gazetë në fund të shkurtit ka bërë me dije se rasti është në duar të prokurorëve ndërkombëtar të EULEX-it. E njëjta gazetë, duke iu referuar avokatit mbrojtës së njërit prej të dyshuarve ka raportuar se katër të arrestuarit pas një muaj qëndrimit në paraburgim janë liruar.

Ata sipas gazetës për një muaj tjetër do të jenë në arrest shtëpiak derisa hetimet ndaj tyre janë duke vazhduar.

Por nga sektori i krimeve ekonomike në Policinë e Kosovës përkatësisht nga ushtruesi i detyrës së udhëheqësit të kësaj njësie gjatë muajit, është thënë se janë duke u hetuar edhe tenderët tjerë për shtrimin e rrugëve, megjithatë ende nuk është parë diçka konkrete në këtë drejtim.

E njëjta gazetë ka raportuar gjatë këtij muaji edhe për një keqpërdorim tjetër. Bëhet fjalë për drejtoreshën e Termokosit të Kosovës, Fëllanza Pula. Ajo sipas gazetës është duke marrë nga dy rroga njëra në një bankë e njëra në tjetrën. Gazeta ka raportuar gjithashtu se në Termokos, kjo drejtoreshë ka punësuar shumë familjarë të saj. Këto i ka mohuar Pula duke e dhënë një arsyetim e cila nga gazeta është quajtur si arsyetim qesharak.

Ajo sipas gazetës, ka thënë “se Kosova është e vogël dhe se është e pamundur që të mos e kesh dikë të familjes në institucionin ku punon”.

⁷ www.koha.net

⁸ Gazeta “Zëri”, 04.02.2010

Ndonëse nga Prokuroria, Lëvizja FOL nuk ka pasur qasje të sigurojë të dhënat, gazeta “Zëri” ka njoftuar se Prokuroria Speciale e Kosovës është duke hetuar Universitetin e Prishtinës. Bëhet fjalë për disa miliona që dyshohen se janë keqpërdorur në Universitetin e Prishtinës gjatë vitet 2005/06. Por gazeta ka raportuar se ende nuk dihen rezultatet konkrete të hetimeve të deritashme apo kur pritet që të ngritët aktakuza.

Zëri gjatë shkurtit gjithashtu ka raportuar për keqpërdorimet në Universitetin Publik të Prishtinës. Gazeta ka paralajmëruar se centralizimi i paralajmëruar i UP-së ia mundëson rektoratit të abuzojë dhe keqpërdorë pozitën e vet

Organizatat e ndryshme për luftën kundër korrupsion

Global Integrity Report

Kosova edhe gjatë muajit shkurt ka vazhduar të perceptohet si një vend me nivel të lartë korrupsioni nga institucionet e huaja. Organizata me seli ne SHBA, “Global Integrity” e cila vlerëson nivelin e qeverisjes dhe të mekanizmave kundër korrupsion në nivelin kombëtar, ka dalë me raportin e saj për vitin 2009. Kosova sipas këtij raporti është vlerësuar me notën 67 – pikë që konsiderohet notë e dobët. Notën më të dobët i ka dhënë legjislativit kosovar, 36. Notë shumë të dobët ka dhënë edhe ekzekutivit e cila është vetëm 44 nga 100, sa është maksimalja. Shumë dobët me 56 vlerësohet edhe përgjegjësia e gjyqësorit kosovar. Ndërsa, pozitivisht ka vlerësuar punën e shoqërisë civile dhe të Agjencioni Antikorrupsion. Kosova në këtë raport ka qenë para Serbisë ndërsa mbrapa Maqedonisë.

Instituti Demokratik i Kosovës (KDI)

Në fillim të muajit Shkurt kemi hasur edhe në reagim nga shoqëria civile. Përkatësisht, Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) në një tryezë me temën “Transparenca gjatë procesit të hartimit të buxhetit dhe menaxhimit të parasë publike” ka vlerësuar se nuk ka transparencë në hartimin e buxhetit për vitin 2010. Kjo kanë thënë ka ngre edhe dyshime rreth menaxhimit dhe shpenzimit të buxhetit.

Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) dhe Lëvizja FOL:

Edhe Lëvizja Fol së bashku me Institutin Demokratik të Kosovës gjatë muajit shkurt, kanë prezantuar para shoqërisë civile dhe partive politike të Podujevës dhe Mitrovicës, Projektligjin për Financimin e Partive Politike, me ç’rast janë nxjerr rekomandime konkrete për ta pasur një ligj sa më të përshtatshëm. Këto tryeza janë zhvilluar në kuadër të programit “Bazë Ligjore dhe Mekanizma Funksional për Qeverisje të Mirë”.

Rekomandimet nga debati përfshinin:

- Sanksionet ndaj partive duhet te ashpërsohen për tu zbatuar ligji; Limitet nga donatoret privat duhet te përcaktohen me ligj;
- Duhet te organizohen debate me shoqata te juristeve te cilët duhet ti hapin dhe ti trajtojnë këto tema;
- Grupet parlamentare nuk duhet te financohen edhe nga buxheti I shtetit; Ne ligj duhet parashihet edhe financimi I degëve te partive.

Lëvizja FOL

Gjatë muajit shkurt Lëvizja FOL ka publikuar raportin Odisejada e Riemërimit të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve ku nxirr në pah parregullsi gjatë riemërimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve ku përfshihen edhe raste të konfliktit të interesit

Fund | Shkurt 2010

Rruga "UCK" 46/5, 10000 Prishtinë,
Mob: +377(0) 44 131 542
www.levizjafol.org | info@levizjafol.org